



REPUBLIKA E KOSOVËS



KOMUNA VUSHTRRI

PROCESVERBAL
Nga mbledhja e II-të për vitin 2011, e Kuvendit Komunal në
Vushtri, mbajtur më 24.2.2011

Mbledhja u mbajt në sallën e Kuvendit Komunal duke filluar në orën **10:10**.

Në këtë mbledhje ishin të pranishëm të gjithë anëtarët e Kuvendit të Komunës në Vushtri.

Të pranishëm në këtë mbledhje ishin edhe: drejtorët e drejtorive komunale, përfaqësues të OSBE-së, përfaqësues të Ministrisë të Administrimit të Pushtetit Lokal, përfaqësues të ICO (Zyra Civile Ndërkombëtare), dhe përfaqësues të mediave të shkruara dhe të shoqërisë civile.

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi z. Ferit Idrizi, kryesues i Kuvendit, i cili konstatoi se ka shumicë për punë.

Në fillim të seancës së Kuvendit, fjalën e mori Nënkryetarja e deritanishme e Komunës së Vushtrrisë, znj. Xhevahire Izmaku, e cila falënderoi për bashkëpunimin që ka pasur me Kryetarin e Komunës, Kryesuesin e Kuvendit dhe kabinetin e qeverisë komunale. Gjithashtu falënderoi për bashkëpunimin edhe përfaqësuesit e mediave. Në fund, ajo tha se si deputete e Kuvendit të Kosovës, do të bën përpjekje që të përfaqëson të gjithë qytetarët e Vushtrrisë, pa dallim, duke qenë në shërbim të interesave të qytetarëve të Vushtrrisë.

Bajram Mulaku, kryetar i Komunës- e falënderoi znj. Izmaku për bashkëpunimin që ka pasur me të, e në vaçanti falënderoi për punën që ka bërë në lëminë e kulturës.

Sami Isrefi, anëtar i Kuvendit- Grupi parlamentar i PDK-së vlerëson lartë punën e znj. Izmakut, pasi që ka bërë punë të jashtëzakonshme në të gjitha nivelet e Komunës së Vushtrrisë.

Në vazhdim filluan diskutimet e anëtarëve të Kuvendit lidhur me rendin e ditës:

Ferit Idrizi, kryesues i Kuvendit- propozoi që në “të ndryshme” të futet rishqyrtimi i vendimit që është marrë në seancën e datës 25.11.2010, lidhur me dhënien në shfrytëzim pa qira të lokaleve të dy shkollave për hapjen e kuzhinave, mirëpo duhet të korrigjohet vendimi, pasi që lokalet në fjalë duhet proceduar përmes procedurës së tenderimit sipas Ligjit për dhënie në shfrytëzim, poashtu propozoi që në “të ndryshme” të futen dy kërkesa për ndihmë financiare për sigurimin e terapisë mjekësore, për: Elheme Isën dhe Ramadan Bajramin. Pastaj propozoi që për shkak të

rëndësisë që ka pika nr. 8 e rendit të ditës, të diskutohet për të duke u zhvendosur si pika nr. 2 e rendit të ditës.

Bajram Mulaku, kryetar i Komunës- lidhur me propozimin që të rishqyrtohet në “të ndryshme” vendimi për hapjen e bufeve në dy shkollat në fjalë, tha se vendimi i Kuvendit është në kundërshtim me Ligjin për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të pronës së komunës. Pra ligji në fjalë e përjashton mundësinë që përmes Drejtorisë së Arsimit ta procedojmë këtë vendim që është marrë nga kuvendi, prandaj duhet të procedohet përmes Drejtorisë për Prokurim.

Qazim Azemi, anëtar i Kuvendit- duke falënderuar Kryetarin e Komunës që publikisht e përmendi rastin kur ai vendim e ka bërë shkeljen e ligjit të cekur nga kryetari, por do të ishte mirë që edhe shumë shkelje tjera që janë bërë në këtë kuvend të revidoheshin. Pastaj lidhur me rendin e ditës, paraqiti vërejtje për Kryesuesin e Kuvendit, pasi që nuk i ka futur në rend dite punët që janë planifikuar për t’u bërë, dhe përmendi se për muajin shkurt në planin e punës së kuvendit është planifikuar edhe plani i punës së Drejtorisë për Prokurim për vitin 2011, kurse në rend dite nuk është fare. Mandej, propozoi që nga rendi i ditës të hiqet pika nr. 9, pasi që edhe pozita edhe opozita kanë qenë kundër rritjes në masë të madhe të tarifave, që janë propozuar për t’u ndryshuar në Rregulloren për tarifa, ngarkesa dhe gjobë komunale. Në vazhdim, ai tha se pajtohet që pika nr. 8 e rendit të ditës të zhvendoset në pikën nr. 2 të rendit të ditës, duke mbështetur harmonizimin e statutit të ri. Në fund në emër të Grupit parlamentar të AAK-së kërkoi përgjigje me shkrim nga Kryetari i Komunës lidhur me vendimin nr. 617/09, të datës 24.09.2009, pasi që me këtë vendim iu është dhënë për shfrytëzim të përkohshëm një pronë Ragip Ibrahimit, kurse prej atij viti nuk kemi informatë (transparencë).

Refik Ramaj, anëtar i Kuvendit- në emër të Grupit parlamentar të LDK-së propozoi që pikat nr. 5 dhe 7 të hiqen nga rendi i ditës, me arsyetimin se në Kuvend kanë propozuar disa herë dhe është aprovuar edhe nga Kuvendi, pasi që kemi thënë që nga diskutimi publik të na vjen një raport i analizës nga diskutimi publik, duke iu bashkangjitur draftrregulloreve, prandaj kërkujmë që të hiqen nga rendi i ditës dhe të vijmë me një aneks të tillë. Gjithashtu lidhur me pikën nr. 9, tha se e mbrojnë qëndrimin që të mos rriten ngarkesat dhe tarifatat, por të shtrihet baza e tyre, pasi që në këtë formë komuna realizon të hyra më shumë, prandaj kërkujmë që edhe pika nr. 9 të hiqet nga rendi i ditës.

Sami Istrefi, anëtar i Kuvendit- tha se Grupi parlamentar i PDK-së pajtohet që të procedohet ky rend dite. Pastaj lidhur me planin vjetor të punës së Drejtorisë për Prokurim, tha se në bazë të LVL-së, neni 52, kjo është kompetencë ekskluzive e KPF-së, dhe ai dokument ka qenë në KPF.

Besim Jashari, anëtar i Kuvendit- propozoi që në “të ndryshme” të diskutohet për çështjen e mbrojtjes së konsumatorëve në Vushtrri, pasi që iu referuar një shkrimi në një gazetë të përditshme, ku shkruante se në Vushtrri po shitet mish i lopëve të ngordhura dhe i lopëve të sëmura. Mandej tha se rastet për kërkimin e ndihmave do të shtohen në Kuvend, pasi që gjendja nuk është e mirë, dhe qytetarët kanë nevojë për përkrahje. Në vazhdim ai tha se në Vushtrri ka thertore të improvizuara, duke mos pasur kushte higjieniko-sanitare, dhe nuk kanë asnjë lloj kontrolli, prandaj nga ai lloj mish mund të vijmë edhe sëmundje. Pastaj tha se ndër çështjet që duhet të diskutohet në Kuvend është çështja e kompensimit të punës së anëtarëve të Kuvendit, duke shtuar se pozita e anëtarëve të Kuvendi Komunal në kuptimin e kompensimit nuk është e kënaqshme.

Sabit Kadriu, anëtar i Kuvendit- tha se është hera e tretë që merremi me Rregulloren e arsimit për shkolla të mesme, edhe pse nuk ka qenë në diskutim publik, por pas gjithë këtij shqyrtimi që i kemi bërë kësaj rregulloreje, ka ardhur koha që sot ta aprovojmë, duke i inkuorporuar vërejtjet që mund t’i paraqesim.

Pajazit Pllana, anëtar i Kuvendit- kërkoi Informatë nga Drejtoria e Shëndetësisë lidhur me gripin e derrave AH1N1, se sa është prekur Komuna e Vushtrrisë dhe

masat që është dashtë me i ndërmarrë Komuna e Vushtrrisë për këtë epidemi të gripit që ka lënë pasoja të rënda.

Bahrije Pillana, anëtare e Kuvendit- tha se qytetarët e Vushtrrisë janë shumë të rrezikuar edhe nga qentë endacakë, prandaj kërkoi Informatë nga drejtoria përkatëse se çka është punuar në këtë drejtim për eliminimin apo largimin e qenëve endacakë. Në vazhdim shtoi se në fshatin Shtitaricë janë të rrezikuar fëmijët dhe të rriturit nga qentë endacakë.

Ferit Idrizi, kryesues i Kuvendit- sa i përket vërejtjes së Q.Azemit, lidhur me planin e punës së Drejtorisë për Prokurim, tha se plani në fjalë është shqyrtuar në KPF, pasi që është kompetencë ekskluzive e KPF-së dhe nuk procedohet për Kuvend. Në vazhdim arsyetoi pse duhet aprovuar rendi i ditës të planifikuar sipas ftesës së rendit të ditës. Kurse lidhur me kërkesën që “në të ndryshme” të diskutohet për mbrojtjen e konsumatorëve, tha se është mirë që të diskutohet në njërin nga seancat e radhës, pasi që për këtë seancë të gjithë jemi të pa përgatitur dhe kjo seancë është shumë e ngjeshur për të hapur edhe debate të tjera.

Bajram Beqiri, drejtori i Drejtorisë për Inspektion- lidhur me shqetësimin e paraqitur nga B.Jashari, njoftoi se ka qenë shqetësuese, duke shtuar se në të vërtetë nuk ka ndodhur, dhe për këtë është bërë demantimi edhe në mjete të informimit. Pastaj tha se ngjarja ka ndodhur në Skenderaj, ku është aksidentuar një lopë dhe lopa është shitur në Drenas, dhe është tentuar të stërshitet edhe në Vushtrri, mirëpo angazhimi i Stacionit policor të Drenasit ka rezultuar me zënien e akterëve, kurse mishi është dërguar në Stacionin policor në Skenderaj, dhe pastaj mishi është asgjësuar.

Në përfundim të diskutimeve rreth rendit të ditës, Kuvendi me 21 vota “për”, 4 “kundër”, të tjerët “abstenim” aprovoi këtë:

Pika nr. 8 e rendit të ditës zhvendoset për t’u diskutuar si pika nr. 2 e rendit të ditës. Kurse në “të ndryshme” futen rishqyrtimi i vendimit që është marrë në seancën e datës 25.11.2010, lidhur me dhënien në shfrytëzim pa qira të lokaleve të dy shkollave për hapjen e kuzhinave, si dhe dy kërkesa për ndihmë financiare për sigurim të terapisë, të paraqitura njëra nga Elheme Isa, kurse tjetra nga Ramadan Bajrami.

R E N D I T E

- 1. Shqyrtimi dhe aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e fundit të KK-së.**
- 2. Shqyrtimi i parë i propozim-vendimit për ndryshimin dhe plotësimin e statutit të komunës.**
- 3. Shqyrtimi i Raportit për punën e Kuvendit të Komunës dhe komiteteve për v. 2010.**
- 4. Shqyrtimi i Raportit financiar të komunës për v. 2010.**
- 5. Shqyrtimi i dytë i Draft-rregullores për përcaktimin e kritereve të ndarjes së mjeteve financiare nga fondi për transfere dhe subvencione për ndihmë momentale entiteteve publike dhe jo publike.**
- 6. Shqyrtimi i Informatës për përfundimin e gjysmë vjetorit të parë të vitit shkollor 2010/2011.**
- 7. Shqyrtimi i Draft-Rregullores për organizimin e punës dhe të mësimin në shkollat e mesme të larta të Komunës së Vushtrrisë.**
- 8. Shqyrtimi i propozim-vendimit për dhënien në shfrytëzim të përkohshëm të tokës në pronësi të Komunës, në fsh. Nedakoc.**

9. Shqyrtimi i dytë i propozim-vendimit për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores për tarifa, ngarkesa dhe gjoba komunale.

10. Eventuale:

a. Rishqyrtimi i vendimit që është marrë në seancën e datës 25.11.2010, lidhur me dhënien në shfrytëzim pa qira të lokaleve të dy shkollave për hapjen e kuzhinave.

b. Kërkesë nga Elheme Isa për ndihmë financiare për sigurim të terapisë mjekësore, dhe kërkesa tjetër nga Ramadan Bajrami për ndihmë financiare për sigurim të terapisë mjekësore.

1. Shqyrtimi dhe aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e fundit të KK-së.

Ferit Idrizi, kryesues i Kuvendit- sugjeroi që fund të diskutimit të pikave të rendit të ditës, në vend të fjalisë “në vazhdim”, të thuhet “në fund të diskutimit lidhur me këtë pikë të rendit të ditës”. Pastaj kërkoi që secilit diskutues në Kuvend t’iu përshkruhet pozita që e ushtron. Poashtu propozoi që përmbajtja e procesverbalit të jetë substanciale.

Në fund të diskutimit lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, Kuvendi pas votimit në mënyrë unanime vendosi me sa vijon:

Aprovohet procesverbali i mbledhjes së fundit të Kuvendit të Komunës, me sugjerimet e paraqitura nga: F.Idrizi.

2. Shqyrtimi i parë i propozim-vendimit për ndryshimin dhe plotësimin e statutit të komunës.

Ferit Idrizi, kryesues i Kuvendit- informoi anëtarët e Kuvendit për punën që ka bërë Komisioni për ndryshimin dhe plotësimin e Statutit të Komunës.

Tasim Gubetini, anëtar i Kuvendit- në emër të Grupit parlamentar të AKR-së paraqiti disa vërejtje lidhur me propozim-vendimin në fjalë, dhe duke iu referuar nenit 70.1, tha se nuk është e nevojshme që të bëhet ky ndërrim, pasi që kemi edhe një Drejtori për Ekonomi, pra të mos na u krijohen dy drejtori për ekonomi. Pastaj lidhur me paragrafin 70.3, propozoi që të formulohet në këtë mënyrë: “Drejtoria për Bujqësi, Ekonomi dhe Zhvillim”. Te neni 72.1, tha se parashikohet transferi i disa përgjegjësive nga drejtorja ekzistuese në Drejtorinë për Buxhet dhe Financa, e që ne nuk pajtohemi me këtë ndryshim, prandaj kompetencat duhet të mbesin ashtu siç kanë qenë, pasi që zyrtarët e këtyre dy drejtorive punojnë rreth 15 muaj dhe kanë filluar shumë projekte nëpër komisione të ndryshme, duke shtuar që ky paragraf nuk duhet të aprovohet.

Nystret Gërxhaliu, anëtar i Kuvendit- duke iu referuar nenit 8, propozoi që të bëhet riorganizimi territorial i këshillave të fshatrave të komunës, sepse bashkësitë lokale janë tejkaluar, dhe kërkohet riorganizimi territorial i komunës në bazë të këshillave të fshatrave, që e përcakton një komision i caktuar i administratës komunale.

Muharrem Shabani, anëtar i Kuvendit- në emër të grupit punues lidhur me propozim-vendimin në fjalë tha se mund të ketë edhe vërejtje edhe sugjerime, duke shtuar se në rastin konkret është bërë përpjekje që në çdo kapitull duke u bazuar në ligj të rregullohet çështja e Statutit të Komunës, pasi që Statuti i mëparshëm ka qenë tepër i shkurtër, dhe si i tillë nuk ka rregulluar shumë lëmi. Në fund kërkoi që të gjitha vërejtjet dhe sugjerimet dhe të gjendet forma që në mënyrë transparente t’iu ofrohet qytetarëve, në mënyrë që edhe ata të japin mendimet dhe propozimet e tyre.

Ismet Gashi, anëtar i Kuvendit- tha se komisioni ka bërë punë të mirë, dhe ka paraparë dispozita në Statut më të avancuara se sa në LVL, dhe përmendi rastin e zgjedhjes së Kryesuesit të Kuvendit, me ç'rast sipas ligjit mbesim pa zgjedhje, nëse pas raundit të dytë kandidatët nuk i marrin shumicën e votave, kurse në këtë propozim për ndryshim të Statutit është dhënë propozimi që të shkohet me kandidatë tjerë. Pastaj tha se në ligj nuk parashihet çështja e shkarkimit të kryesuesit, kurse hartuesit e këtyre ndryshimeve kanë paraparë edhe formën se si do të bëhet shkarkimi i kryesuesit, prandaj duhet të kemi kujdes që të mos vjen në kundërshtim me ligjin. Gjithashtu komisioni është dashur ta ketë parasysh edhe një çështje tek neni për përshkrimin e punëve dhe detyrave të drejtorive, tek inspekcioni përmendet edhe Inspekcioni i Tregut, por me Ligjin mbi Inspektoratin e Tregut të gjithë inspektorët e tregut janë punëtorë të Ministrisë për Tregti dhe Industri, kështu që komuna nuk mund të kërkon përgjegjësi direkte prej tyre, prandaj nuk ka nevojë në Statut të jenë punët dhe detyrat e tyre, duke kërkuar që ministria në fjalë t'iu gjen edhe zyret e punës inspektorëve në fjalë.

Ferit Idrizi, kryesues i Kuvendit- lidhur me propozimet për ndryshime të avancuara, sqaroi se është Udhëzimi Administrativ që e plotëson LVL-në, pikërisht nenin për zgjedhjen e Kryesuesit të Kuvendit, por aty duhet të plotësohet, pasi që në bazë të Udhëzimit Administrativ në raundin e tretë zgjedhet me shumicën e thjeshtë, por nëse as në raundin e tretë nuk mund të zgjedhet, atëherë rifillon rizgjedhja.

Bajram Mulaku, kryetar i Komunës- e falënderoi komisionin në fjalë për punën që ka bërë për ndryshimin dhe plotësimin e Statutit të Komunës. Pastaj sugjeroi që të gjithë deputetët nëse kanë vërejtje, brenda muajit t'i dorëzojnë me shkrim në Sekretari, pastaj sekretaria ia përcjellë komisionit të fjalë, dhe propozim-vendimi në fjalë duhet të publikohet në web-faqe të Komunës, në mënyrë që të kenë qasje qytetarët gjatë tërë muajit, mirëpo edhe në forma tjera. Mandej tha se çdo nen i këtij statuti duhet të ketë mbështetje në ligj. Në vazhdim lidhur me Komitetin për Komunitete, tha se çdo muaj mbajnë takime, por nga ato takime nuk ka ndonjë rezultat konkret, prandaj sugjeroi që me një paragraf të veçantë të përcaktohet maksimumi i mbajtjes së mbledhjeve të këtij komiteti, pasi që është e tepërt mbajtja për çdo muaj e mbledhjeve të këtij komiteti, dhe gjithashtu duhet me i raportuar dikujt Komiteti për Komunitete. Te neni 57 nuk figuron Komiteti për Auditim, prandaj ky komitet edhe në bazë të ligjit ekziston, prandaj duhet me paraparë edhe me Statut. Gjithashtu kërkoi që edhe me Statut të përmendet fakti që këto komitete duhet të kompensohen. Te neni 45.4, tha se në praktikë është shumë vështirë që të dërgohet materiali 7 ditë pune para seancës së kuvendit, prandaj do të ishte mirë të mendohet që të zvogëlohet ky afat. Te neni 70, tha se nëse ndahet ekonomia dhe bujqësia, po bëhet një drejtori e re, duke shtuar se Komuna e Vushtrrisë është ndër komunat që ka më së shumti drejtori. Në vazhdim tha se është menduar që Drejtorja e Buxhetit ta përfshin sektorin e ekonomisë, por kjo nuk do të jetë praktike, pasi që kjo drejtori është e stërngarkuar, duke sugjeruar që të mos transferohet ekonomia në Drejtorinë e Buxhetit.

Në fund të diskutimit lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, Kuvendi pas votimit në mënyrë unanime vendosi me sa vijon:

Ipet në diskutim publik Propozim-vendimi për ndryshimin dhe plotësimin e Statutit të Komunës.

Diskutimi publik fillon nga data 25.02.2011 dhe zgjatë deri më 15.03.2011.

Obligohet Komisioni që të hartojë tekstin e spastruar të Statutit në bazë të vërejtjeve nga diskutimi publik dhe propozoj për shqyrtim dhe aprovim në mbledhjen e radhës së KK-së.

3. Shqyrtimi i Raportit për punën e Kuvendit të Komunës dhe komiteteve për v. 2010.

Ferit Idrizi, kryesues i Kuvendit- tha se në këtë raport është munduar me përfshirë në pika të shkurtëra punën e Kuvendit dhe të komiteteve.

Veli Karaça, anëtar i Kuvendit- tha se raporti në fjalë e ka formën e raportit, por i mungojnë konkluzionet, sepse pas një analize që iu është bërë punës, është dashur të nxirren disa konkluzione, pastaj për t'i përmbushë ato konkluzione duhet të rekomandohet se çfarë të bëhet. Pastaj lidhur me rekomandimet, tha se te rekomandimet që janë dhënë ka shumë çështje që kanë sjellë probleme gjatë punës së Kuvendit, duke filluar prej mos nënshkrimit të dokumenteve, apo mos shqyrtimit në instanca më të ulta, mungesës së rekomandimeve për Kuvendin, mos prezencës së personave përgjigjës që i kanë proceduar materialet për Kuvend dhe mos referimit të tyre në KPF dhe shpesh edhe në Kuvend. Kurse tek kompetencat e pa deleguara, tha se Kuvendi nuk e ka menaxhuar mirë pasurinë e paluajtshme, pasi që Komuna akoma nuk e din se cilat janë asetet e saj, përndryshe Komuna do të kishte të hyra shumë më të mëdhaja, sikur ta menaxhonte mirë pronën e vet. Në vazhdim tha se një ndër problemet është edhe emërimi i rrugëve, rrugicave dhe vendeve publike, duke shtuar se ka kaluar një kohë e gjatë që nuk është marrë vendim për emërimin e rrugëve, edhe pse disa rrugë janë emëruar dhe disa rrugëve iu është ndërruar emërtimi, por këto emërtime rrugësh nuk kanë kaluar nëpër Kuvend. Mandej tha se në punën e mirë të Kuvendit ka kontribuar edhe qasja pozitive e opozitës, dhe iu është krijuar hapësirë administratës komunale për të përmbushur detyrat e veta. Pra janë nxjerrë shumë rregullore dhe vendime për të ndihmuar punën, por mungon një vlerësim se sa e kanë ndihmuar, pasi që asnjë vendim apo kërkesë nuk është refuzuar nga Kuvendi, që ka ardhur nga Kryetari i Komunës, apo ndonjë drejtori komunale. Në vazhdim lidhur me afatin e dërgimit të materialit për seanca të Kuvendit, tha se një anëtar i Kuvendit i mjafton 7 ditë të javës (edhe nëse nuk janë ditë pune) për t'u përgatitur për seancë, por shqetësuese është mungesa e Sekretarisë së Kuvendit, duke shtuar se një sekretari e përbashkët e Kryetarit dhe Kuvendit shpeshherë po e anashkalon Kuvendin dhe si anëtarë të Kuvendit për shumë çështje po mbesim të pa informuar, duke përmendur si shembull mos informimin e tij lidhur me organizimin e manifestimit nga Komuna me rastin e përvjetorit të Ditës së Pavarësisë. Në fund tha se KPF-ja numerikisht ka qenë e vogël dhe përkrahja që i ka munguar nga faktorët tjerë, ka ndikuar që KPF-ja të mos e përmbushë misionin e vet, duke shtuar se shumë herë rekomandimet e KPF-së nuk kanë ardhur në Kuvend, dhe nuk i ka përfillur askush.

Sami Istrefi, anëtar i Kuvendit- tha se ky raport do ta pasurohej edhe më shumë sikur të përfshiheshin në të edhe disa informata, të cila KPF-ja i ka nxjerrë që të raportoj për punën e disa institucioneve me rëndësi për Komunën e Vushtrrisë, siç janë: Policia e Kosovës, Kompania "Uniteti" dhe Ujësjiellësi.

Qazim Azemi, anëtar i Kuvendit- tha se i mbështet tërë ato që janë paraqitur në raportin në fjalë, por duhet të plotësohet ky raport edhe me disa propozime tjera, duke shtuar se do të ishte mirë që në raportin në fjalë të përfshiheshin edhe pyetjet dhe përgjigjet që janë bërë gjatë seancave të Kuvendit. Poashtu është dashur të përmendet që mbi 50 % të rasteve që kemi bërë pyetje nuk i kemi marrë përgjigjet me shkrim, prandaj ka qenë e nevojshme që të specifikohen se nga sa pyetja ka bërë secili grup parlamentar. Gjithashtu, paraqiti vërejtje për KPF-në, pasi që KPF-ja ka qenë e obliguar që brenda afatit prej 30 ditësh ta shqyrton tubimin publik me qytetarë dhe është dashur të informohet Kuvendi, por nuk është informuar fare, prandaj kërkoi që të shtohet puna e komiteteve dhe të kompensohen për punën e tyre.

Besim Jashari, anëtar i Kuvendit- duke iu referuar raportit në fjalë, lidhur me punën e Komitetit për Komunitete, pyeti se ky komitet a i ka raportuar ndonjëherë

Kuvendit, pasi që edhe është trup i Kuvendit. Pastaj edhe komitetet konsultative që i ka formuar Kuvendi, tha se asnjë nga këto komitete nuk i ka raportuar asnjëherë Kuvendit se sa mbledhje i ka mbajtur, cilat çështje i ka shqyrtuar dhe cili është rezultati. Mandej, lidhur me paraqitjen e rekomandimeve në fund të raportit në fjalë, tha se është dashtë që dikund të figuron edhe pjesëmarrja e anëtarëve të Kuvendit në seancat e Kuvendit, dhe t'i raportohet Kuvendit se cila ka qenë pjesëmarrja e anëtarëve të Kuvendit në mbledhjet e Kuvendit.

Ferit Idrizi, kryesues i Kuvendit- i mbështeti sugjerimet e dhëna nga V.Karaça, S.Istrefi, si dhe sugjerimet që i paraqiti B.Jashari lidhur me formën e funksionimit të Komitetit për Komunitete. Kurse lidhur me emërtimin e rrugëve, tha se të gjitha rrugët janë emërtuar në bazë të vendimit të Kuvendit.

Ismet Gashi, anëtar i Kuvendit- tha se në raportin në fjalë është dashur të ceken edhe vendimet e aprovuara nga ky Kuvend, por që nuk janë zbatuar fare, pengesat ligjore që kanë qenë, duke shtuar se në seancën e prillit janë aprovuar dy vendime: vendimi për kompensimin për mbikëqyrje të objekteve (projekteve) dhe vendimi për kompensim për pranim teknik, dhe këto dy vendim nuk janë zbatuar asnjëherë.

Në fund të diskutimit lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, Kuvendi pas votimit në mënyrë unanime vendosi me sa vijon:

Aprovohet raporti në fjalë, duke inkorporuar edhe vërejtjet dhe sugjerimet e anëtarëve të Kuvendit.

4. Shqyrtimi i Raportit financiar të komunës për v. 2010.

Refik Ramaj, anëtar i Kuvendit- lidhur me raportin në fjalë, fjalia në faqe nr. 2 “ne konfirmojmë, për sa kemi njohuri dhe besim...”, tha se nuk është fjali profesionale, pasi që nuk mund të thuhet në financa “sa kemi njohuri dhe kemi besim”. Në faqe 3, paraqiti vërejtje se pasqyrat janë shprehur me mijëra euro, dhe kur shumëzohen dalin me miliarda euro, pra pasqyrat nuk janë të sakta dhe nuk janë objektive. Faqe 6, komenti duhet të bëhet me një analizë dhe është dashur të përcillet me grafikone për të qenë më të qartë. Poashtu komunalitë janë më të larta, por nuk është dhënë shpjegim cilat janë efektet. Pastaj te “grantet e donatorëve”, tha se pasqyrat e paraqitura flasin për miliarda, mandej te “komentet” nuk ka sqarime. Në vazhdim tha se niveli i rritjes te subvencionet është për keqardhje. Pastaj i vlerësoi pozitivisht rezultatet e paraqitura nga “Investimet kapitale”. Te “grantet dhe ndihmat”, duke iu referuar komentit, pyeti se çka ka ndikuar në këtë diferencë të hollash më të vogël se në vitin 2009. Mandej, te “pranimet kapitale”, te “fitimet nga shitja” tha se pasqyrat janë të paraqitura gabimisht. Në fund lidhur me “të hyrat vetjake”, kërkoi që të ndahet një shtyllë dhe të sqarohet se cila janë të hyra nga vitet e kaluara, në mënyrë që të dihet se cila është gjendja reale.

Zeqir Hasani, anëtar i Kuvendit- tha se pasqyrat financiare për vitin 2010 figurativisht janë të paraqitura mirë, kurse teknikisht kanë shumë gabime dhe veprime jo profesionale. Pastaj shpenzimi i mjeteve buxhetore është bërë në masë të kënaqshme nga aspekti kuantitativ, kurse nga aspekti kualitativ kemi vërejtje esenciale. Pastaj lidhur me pozicionin e të hyrave vetanake, tha se pasi që kemi mjete të mjaftueshme për mallra dhe shërbime nga buxheti i konsoliduar i Kosovës, nuk ka nevojë të bëhet bartja e mjeteve nga të hyrat në mallra dhe shërbime, por është mirë që këto mjete të shkojnë në rritjen e subvencioneve dhe përkrahjen e bujqësisë, kulturës, rinisë dhe sportit. Kurse sa i përket granteve, përveç granteve të brendshme që kanë rrjedhur nga participimi i qytetarëve, grante të jashtme nuk kemi pasur, dhe kjo tregon që nuk janë krijuar politika të favorshme për joshjen e investitorëve të jashtëm. Në vazhdim tha se edhe pse ka një zvogëlim të shpenzimeve në mallra dhe shërbime, përsëri kërkoi që në të ardhmen akoma të zvogëlohen këto mjete, me qëllim që këto mjete t'i dedikohen projekteve investive. Mandej, tha se nuk është bërë specifikimi i shpenzimeve sipas zërave kontabël, por

janë bërë vetëm në vija të trasha. Gjithashtu, mungon një pasqyrë për mjetet e painkasuara të vitit 2010, dhe nuk kemi të pasqyruara mjetet teprice që barten në vitin 2011. Lidhur me “të hyrat vetanake”, te pozicioni “të hyrat nga shitja e pasurisë”, kërkoi sqarime nga përgjegjësi për buxhet dhe financa se çfarë shitjesh janë bërë. Kurse sa i përket të hyrave vetanake, tha se kemi hapësirë edhe më të madhe për rritjen e të hyrave vetanake, pasi që nga të gjitha burimet e mundshme të të hyrave, i kemi të painkasuara rreth 386.400 €, kemi 12 % të bizneseve të pangarkuara me aktvendime mbi taksën komunale, si dhe kemi rreth 30 % të taksave dhe tatimit në pronë të painkasuara. Lidhur me “pranimet kapitale”, te komenti që flet për shitjen e veturave të vjetra, tha se është dashtë që ky pozicion të futet te shitja e pasurisë, te të hyrat vetanake, pasi që janë të hyra nga shitja e veturave. Gjithashtu tha se obligimet e pa paguara ndaj furnitorëve për vitin 2010 kanë shënuar rritje në krahasim me vitin 2009. Ndërsa lidhur me përmbledhjen e pasurive jo financiare, është cekur disa herë edhe vitin e kaluar që çdo ndërmarrje dhe çdo institucion duhet të ketë regjistrin mbi asetet e komunës, prandaj është shumë shqetësuese pasi që në vitin 2009 i kemi pasë mbi 10 milionë, kurse në vitin 2010 nuk paraqitet asgjë, kur dihet që edhe në bazë të ligjit, por edhe të Statutit të Komunës duhet të jetë reregjistrimi i mjeteve themelore, duhet të bëhet rivlerësimi i mjeteve themelore, dhe amortizimi i mjeteve themelore sipas shkallëve, si dhe inventarizimi i mjeteve themelore. Në fund tha se edhe vitin e kaluar kam kërkuar që Auditori i Brendshëm të merret me auditimin e buxhetit së paku dy herë në vit, kurse deri më tani nuk kemi asgjë, duke shtuar se zyra e Auditorit të Brendshëm duhet të kryen auditimin e pasqyrave, para se ta kryen Auditori i Jashtëm.

Samir Istrefi, anëtar i Kuvendit- tha se në bazë raportit në fjalë, shihet se në Komunën e Vushtrrisë ka ndodhur pastërtia më e mirë e mundshme e shpenzimit të mjeteve financiare, të cilat janë planifikuar dhe realizuar nga Kryetari i Komunës dhe drejtorët e drejtorive komunale, duke shtuar se nga ky raport shihet se ka rritje të të hyrave vetanake, gjithashtu ka rritje në kategorinë e shpenzimeve kapitale në shumë prej 400.000 €. Në fund tha se pasqyrat financiare kanë shënuar një progres të theksuar.

Besim Jashari, anëtar i Kuvendit- tha se çdo aspekt i raportimit duhet të respektohet dhe t'i kushtohet vëmendje, në mënyrë që raportet të na u prezantohen të jenë të qarta dhe të kuptueshme, kurse raporti në fjalë është formë e raportimit dhe komunikimit në mes të drejtorisë përkatëse komunale dhe departamentit përkatës në Ministrinë për Ekonomi dhe Financa, dhe shtoi se Drejtoria për Buxhet dhe Financa duhet ta ketë parasysh se nuk aplikohet formë e njëjtë e raportimit edhe në raport me Kuvendin Komunal, sepse Kuvendi nuk është institucion profesional financiar, por është organ i cili e mbikëqyrë punën e ekzekutivit. Pastaj tha se çdo raport që paraqesin drejtoritë komunale në Kuvend, paraprakisht kalojnë përmes KPF-së, prandaj bëri një vërejtje për KPF-në dhe Zyrën e Auditorit të Brendshëm, pasi që këta janë filtri i parë, së bashku me Kryetarin e Komunës, për ta ruajtur drejtorinë në fjalë nga shkeljet. Në fund lidhur me komentet që janë paraqitur në raportin në fjalë, tha se në komente duhet të ipen arsye pse janë rritur ose pse janë zvogëluar shpenzimet.

Nystret Gërxhaliu, anëtar i Kuvendit- tha se pasqyrat financiare janë një nga dokumentet kryesore të punës një vjeçare të një institucioni apo të një organizate themelore prodhuese. Në vazhdim sugjeroi që shkurtesat të sqarohen. Pastaj për të qenë raporti më i qartë, sugjeroi që në mënyrë grafike të paraqiten shifrat. Mandej tha se disa shënime përsëriten në disa tabela, prandaj këtë raport e ka bërë voluminoz. Gjithashtu tha se nga ana përmbajtësore raporti në fjalë tregon një vit të suksesshëm, duke shpresuar që ky trend të vazhdon edhe këtë vit, duke shtuar se në bazë të raportit shihet se subvencionet, shpenzimet kapitale dhe të hyrat vetanake janë më të larta. Në fund duke iu referuar faqes nr 19 të raportit në fjalë, lidhur me

ndërtesat dhe paisjet, tha se nuk është paraqitur shkalla e amortizimit apo zhvlerësimit.

Isuf Jashari, drejtor i Drejtorisë për Buxhet dhe Financa- tha se raporti vjetor për pasqyrat financiare është vetëm një informatë për anëtarët e Kuvendit, pasi që drejtorja përkatëse e ka përgatitur edhe raportin vjetor, të cilin në seancën e radhës do ta marrin të gjithë anëtarët e Kuvendit, por kjo pasqyrë financiare është përgatitur në bazë të Udhëzimit Administrativ nr. 16/2010. Në vazhdim paraqiti sqarime shtesë lidhur me raportin në fjalë.

Bajram Mulaku- kryetar i Komunës- tha se me rishikim është ngritur planifikimi rreth 1 milion e gjysmë, dhe ngritja është bërë me qëllimin që të bëhet presion në të gjitha drejtoritë , në mënyrë që të kemi inkasim më të madh, dhe ai presion ka rezultuar pozitivisht. Pastaj tha se të hyra më të mira se sa në vitin paraprak ka në tatim në pronë, kurse në taksë komunale është më dobët se sa që është bërë në planifikimin e dytë, përmes rishikimit. Mandej paraqiti pakënaqësi lidhur me të hyrat nga pasuritë komunale, prandaj është duke u angazhuar në maksimum për ta përmirësuar gjendjen. Në vazhdim tha se Komuna për herë të parë përmes Drejtorisë për Bujqësi ka shpallur tender për disa parcela të tokës bujqësore të Komunës, dhe në këtë mënyrë do të ketë disa të hyra prej tyre. Në fund tha se më së shumti të hyra është dashtë me pasë nga Drejtoria e Urbanizmit, dhe shtoi se që nga pas lufta shumica e ndërtimeve janë bërë pa leje, mirëpo legalizimi i tyre nuk po funksionon deri më tash, poashtu tha se është bërë përpjekje për ta bërë një Rregullore, nuk ka funksionuar, por përsëri duhet vazhduar për ta bërë atë Rregullore, dhe kërkoi që të niset puna nga pika zero, duke përmendur si shembull pozitiv formën e veprimtimit të Komunës së Prishtinës.

5. Shqyrtimi i dytë i Draft-rregullores për përcaktimin e kriterëve të ndarjes së mjeteve financiare nga fondi për transfere dhe subvencione për ndihmë momentale entiteteve publike dhe jo publike.

Veli Karaça, anëtar i Kuvendit- tha se kapitujt e Draft-rregullores në fjalë nuk janë shënuar siç duhet, poashtu shënimi i kapitujve ka filluar nga nr. III. Pastaj te neni 3 përdoret termi “etnitetet”, kurse te neni 4 përdoret termi “entitetet”, duke shtuar se ka edhe gabime tjera teknike në disa nene. Te neni 14 shuma maksimale 300 €, propozoi që të bëhet 500 €, pasi që në këtë mënyrë edhe harmonizohet neni në fjalë me nenin nr 8. Lidhur me nenin 15, tha se nëse komisioni është profesional, a ka nevojë drejtori me pasë këtë kompetencë për ta ndryshuar propozimin e komisionit në fjalë.

Sabit Kadriu, anëtar i Kuvendit- propozoi që draft-rregullorja në fjalë të kalon përmes lektorit, pasi që ka gabime të mëdha. Pastaj te neni 16 propozoi këtë reformulim: “kërkesa mund të shqyrtohet pozitivisht në afatin prej 30 ditësh, që nga momenti i shqyrtimit të saj”. Te neni 18, fjalia “do të mbisundojnë” , propozoi të zëvendësohet me fjalinë “do të merren parasysh”.

Bajram Mulaku, kryetar i Komunës- tha se kjo rregullore është propozuar nga Auditori i Brendshëm, pasi që është ngarkesë shumë e madhe edhe për Kryetarin që ta bën ndarjen e subvencioneve, prandaj është mirë që përgjegjësinë në këtë fushë ta ndajmë së bashku me anëtarët e Kuvendit. Në vazhdim lidhur me kërkesat për ndihmë financiare për shërim, tha se duhet të jemi të kujdesshëm, pasi që shpejt mund të shpenzohen subvencionet dhe disa muaj nuk mund t'i ndihmojmë askujt, duke shtuar se nuk mjaftojnë as subvencionet për t'iu ndihmuar të gjitha rasteve që paraqiten me sëmundje. Mandej tha se për këtë vit ka subvencione më pak, sepse një pjesë e subvencioneve është e orientuar për ndërtimin e shtëpive për njerëzit që janë pa strehim. Gjithashtu njoftoi se nga subvencionet financohet shëndetësia, sporti, kultura, të varfërit dhe të sëmurët.

Ferit Idrizi, kryesues i Kuvendit- duke iu referuar nenit 13, te pjesa e fjalisë "...për ndihmën momentale...", propozoi që t'i shtohet kjo pjesë dhe të thuhet "nga neni 11".

Safet Idrizi, drejtor i Drejtorisë për Shëndetësi dhe Mirëqenies Sociale- njoftoi se është përpjekur që të inkorporon në këtë draftrregullore vërejtjet dhe sugjerimet që janë dhënë nga anëtarët e Kuvendit, në seancën e kaluar, poashtu njoftoi se janë ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme në përgatitjen e diskutimit publik për këtë draft-rregullore. Në vazhdim paraqiti sqarime shitesë lidhur me draft-rregulloren në fjalë. Në fund lidhur me çështjen e ngritur nga P.Pllana, njoftoi se ka qenë një rast që ka qenë i dyshuar si i infektuar me visurin AH1N1, por të dhënat laboratorike kanë rezultuar negativisht.

Në fund të diskutimit lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, Kuvendi pas votimit në mënyrë unanime vendosi me sa vijon:

Aprovohet rregullorja në fjalë, duke inkorporuar edhe vërejtjet e anëtarëve të Kuvendit: V.Karaça, S.Kadriu, dhe vërejtjen e kryesuesit të Kuvendit, F.Idrizi.

6. Shqyrtimi i Informatës për përfundimin e gjysmë vjetorit të parë të vitit shkollor 2010/2011.

Qazim Azemi, anëtar i Kuvendit- tha se në informatën në fjalë do të ishte mirë të ketë një tregues se si qëndron puna me nivelin zero, pra për çerdhe dhe për fëmijët parashkollor. Pastaj duke iu referuar tabelës nr 2, tha se kemi rënie të suksesit, por edhe zbritje të numrit të nxënësve, duke shtuar se është dashtë të jepet një koment nga Drejtoria e Arsimit pse ka rënie të suksesit dhe zbritje të numrit të nxënësve, prandaj kërkoi që të bëhet një analizë pasi që kjo gjendje është brengosëse. Mandej lidhur me suksesin e shkëlqyeshëm të nxënësve, pyeti se a është reale gjendja e paraqitur e këtij sukcesi të shkëlqyeshëm në tabelën nr 1, po kështu qëndron puna edhe në tabelat tjera, prandaj propozoi që të bëhet një analizë se a po jepen nota formale, apo është sukses real, ashtu qysh është paraqitur. Në vazhdim lidhur me shkollat e mesme tha se ka një disproporcion, pasi që shkollat e mesme, në gjysmëvjetor të parë po ka një shtrëngesë më të madhe, kurse në nivelet tjera më lehtë po marrin nota të larta, prandaj është mirë që ta kemi një pasqyrë reale të suksesit.

Vlora Qirezi, anëtare e Kuvendit- duke iu referuar tabelës nr 1, pyeti se a mund të jenë 96.25 % e nxënësve pa nota të dobëta, pasi që nëse krahasohet sukcesi i nxënësve në shkollat fillore me suksesin e nxënësve të shkollave të mesme, e që është 67.37 %. Në vazhdim tha se sipas të dhënave tabelare, krahasuar me vitin e kaluar është një ngritje e vogël, por ky sukses nuk është aq i kënaqshëm, prandaj duhet një aktivitet suplementar nga Drejtoria e Arsimit dhe nga personeli arsimor i shkollave. Pastaj tha se në këtë informatë nuk ka të dhëna lidhur me aktivitetet e lira të nxënësve, dhe shtoi se drejtoria përkatëse duhet t'iu rekomandoj shkollave që të zhvillojnë aktivitete të lira me nxënës, pasi këto aktivitete ndikojnë në përmirësimin e suksesit të nxënësve, por kanë edhe karakter edukativ. Gjithashtu tha se është një numër i nxënësve të pa notuar, dhe kjo është për shkak të mos vijimit të mësimin, dhe pyeti se ky mos vijim a është për shkak të kushteve ekonomike, apo ka arsye të tjera. Në fund tha se duke pasur parasysh gjendjen ekonomike sociale, Grupi parlamentar i LDK-së propozon që Komuna e Vushtrrisë të shqyrton mundësitë buxhetore që vajzave nga fshatrat të familjeve me kushte të rënda ekonomike, të cilat janë nxënës të shkollave të mesme të larta t'iu ndan bursa.

Esat Beka, anëtar i Kuvendit- duke u bazuar në informatën në fjalë, tha se është një përparim në gjysmëvjetorin e parë të vitit 2011, krahasuar me vitin 2009/2010, kurse sa i përket shkollës së mesme profesionale, është një rënie krahasuar me vitin paraprak.

Besim Jashari, anëtar i Kuvendit- tha se në këtë informatë janë përmbledhur të dhëna statistikore që tregojnë për suksesin që kanë pasur shkollat në Komunën e Vushtrrisë në të tri nivelet, dhe shtoi se kur po është në pyetje çështja e arsimit, nuk po tregojmë seriozitetin e duhur, e që është çështje jashtëzakonisht serioze. Pastaj tha se kjo informatë që do tregojë për përfundimin e gjysmëvjetorit të parë, do të duhej të përfshinte më shumë të dhëna, dhe do të duhej të përfshihej edhe fakti se në disa shkolla të Komunës sonë gjysmëvjetori i parë nuk kishte filluar mirë, pasi që ka pasur probleme me ngrohjen. Pastaj tha se në gjysmëvjetorin e parë të viti të kaluar 70 % të nxënësve në nivele të caktuar kanë mbetur me nota negative, kurse tash ka një përmirësim, pasi që rreth 66 % kanë kaluar. Poashtu një përmirësim vërehet në tri shkollat e mesme, kurse prej klasës së I-rë deri në të IX-tën shihet se ka një rënie, duke shtuar se çështja e arsimit duhet të ketë vëmendjen më të madhe edhe nga ana e Kryetarit të Komunës. Në fund tha se në bazë të një informate që ka marrë, se në një shkollë të caktuar kanë humbur disa ditare, dhe drejtori i Drejtorisë së Arsimit ka shkuar dhe ka intervenuar personalisht drejtpërsëdrejti, prandaj lidhur me këtë kërkoi sqarim nga drejtori i arsimit.

Qerim Selimi, drejtor i Drejtorisë për Arsim- tha se rezultati i paraqitur në informatën në fjalë është i vërtetë, dhe shënime që kanë ardhur nga shkollat janë shënime adekuate të cilat i kemi proceduar për ministrinë përkatëse, dhe të njëjtat janë edhe për anëtarët e Kuvendit, dhe shtoi se dyshimet janë të pabazuara lidhur me atë se këto rezultate nuk janë të vërteta. Pastaj tha se në bazë të një analize që është bërë, sukseksi në nivelin e parë dhe të dytë është më i dobët krahasuar me gjysmëvjetorin e parë të vitit të kaluar, kurse arsyeja mund të jetë rritja e kriterit, ose është arsyeja e mos angazhimit të nxënësve, ose e mos punës së profesorëve. Në vazhdim paraqiti sqarimet shtesë lidhur me informatën në fjalë. Sa i përket kërkesës së grupit parlamentar të LDK-së, tha se në Drejtorinë e Arsimit kanë ardhur shumë kërkesa nga nxënësit e viseve rurale që janë në shkollat e mesme, dhe që kërkojnë ndihmë minimale për pagesën e udhëtimit, prandaj kishte me qenë mirë që në kuadër të ndarjes së bursave për fakultete, të parashikohen ndarje të bursave edhe për nxënësit në fjalë. Lidhur me çështjen e ngritur nga B.Jashari, u përgjigj se kanë humbur pesë ditare, dhe në të njëjtën ditë ka vizituar shkollën, ka biseduar me drejtoreshën e shkollës dhe me nxënësit, kurse në mbrëmje ka realizuar takim me të gjithë prindërit, dhe ka qenë qëllimi që të rritet bashkëpunimi në mes të nxënësve, arsimtarëve dhe prindërve, dhe njoftoi se ka pasur një gatishmëri nga Këshilli i shkollës që të organizohet një rojtar për shkollën, pasi që shkolla nuk ka rojtar, dhe shtoi se ditaret e humbur janë kompensuar. Në fund lidhur me pyetjen e Q.Azemit, u përgjigj se asnjë shkollë nuk e kemi ku mbahet mësimi parafillor, por kemi planifikuar mjete që këtë vit të bëhet privatizimi i shërbimeve teknike në shkollat e mesme dhe në këtë mënyrë lirohen 20 punëtorë, dhe të njëjtit të angazhohen në mbajtjen e mësimit parafillor.

Bajram Mulaku, kryetar i Komunës- tha se emërtimi i kësaj informate është i gabuar, pasi që është dashur të shkruhet "Informatë për suksesin e nxënësve në shkollat e komunës, në gjysmëvjetorin e parë të vitit shkollor 2010/2011". Pastaj tha se është brengosëse fakti që në shkollat fillore ka rënie të suksesit, dhe është shumë pozitive që në shkollat e mesme të larta ka ngritje. Mandej lidhur me parashkollorët, tha se nuk e kemi gjendjen e mirë me parashkollorët, prandaj duhet patjetër të ndërmerret diçka. Në vazhdim tha se ndër punët më pozitive është bartja e organizuar e nxënësve. Kurse e mbështeti propozimin e V.Qirezit që vajzave me gjendje të rëndë sociale që vijnë nga viset rurale në shkollat e mesme t'iu ndahen bursa, duke shtuar që për këtë vit për ndarjen e bursave të tilla mund të shfrytëzohen vetëm donacionet, pasi që nuk ka mjete tjera të planifikuara. Gjithashtu kërkoi nga drejtori i arsimit që të angazhohet në maksimum që vitin e ardhshëm të fillon punën një paralele e shkollës së muzikës në Vushtrri.

7. Shqyrtimi i Draft-Rregullores për organizimin e punës dhe të mësimimit në shkollat e mesme të larta të Komunës së Vushtrrisë.

Selvete Sholla, anëtare e Kuvendit- lidhur me draft-rregulloren në fjalë tha se disa vërejtje tona janë marrë parasysh e disa nuk janë marrë, duke shtuar se kanë kërkuar që të mos bëhet me pagesë marrja e një vërtetimi nga nxënësi, prandaj përsëri kërkoi që të hiqet nga kjo draft-rregullore pagesa e tillë, pasi që gjendja ekonomike-sociale është e vështirë. Gjithashtu propozoi që të shtohet edhe një nen që përcakton shumën për marrjen e dokumenteve duplikat nëpër shkolla, pasi që vlera e përgjithshme për marrje të dokumenteve dublikate është e lartë, dhe nuk ka parë ndonjë Udhëzim Administrativ, përkundër faktit që e ka kërkuar në dy shkolla udhëzimin në fjalë.

Sabit Kadriu, anëtar i Kuvendit- lidhur me nenin 8.2, tha se është mirë që është shtuar nenin në fjalë, sepse ruhet inventari i shkollës, pasi që ka nxënës të papërgjegjshëm të cilët janë destruktivë dhe e dëmtojnë inventarin e shkollës, dhe për këtë duhet që familjet e tyre të paguajnë gjobën. Pastaj tha se nuk e ka të qartë pse është ndërruar nocioni prej “arsimtar” në “mësimdhënës”, duke shtuar se që të dyja janë fjalë sinonime. Te neni 12 propozoi që t’i shtohet edhe paragrafi 12.11 me këtë përmbajtje: “në raste të jashtëzakonshme një arsimtar mund të caktohet kujdestar për dy paralele”. Mandej tha se është kundër që shkollat të lëshojnë vërtetime me pagesë. Në fund paraqiti një propozim të tre drejtorëve të shkollave të mesme, të cilët kanë propozuar që për vërtetimin të jetë pagesa 1 €, pagesa për dëftesat duplikat të jetë 2 €, pagesa për diplomë duplikat të jetë 3 €, dhe shtoi se i mbështetë këto çmime të propozuara për duplikat, pasi që ka nxënës të pandërgjegjshëm, të cilët nuk i kushtojnë rëndësi ruajtjes së dokumenteve.

Melihate Basholli, anëtare e Kuvendit- te neni 13.8 propozoi që t’i shtohet edhe kjo fjali: “nota përfundohet me ngjyrë të kuqe”.

Bahrije Pllana, anëtare e Kuvendit- tha se në nenin 17 mungojnë detyrat e këshillit të shkollës dhe të këshillit të nxënësve, prandaj propozoi që të përfshihen përgjegjësit e këtyre dy këshillave në fjalë, pasi që këta këshilla janë një opozitë e mirëfilltë për drejtorin, dhe shtoi se Grupi parlamentar i AAK-së e mbështet rregulloren në fjalë, dhe kërkojmë nda Drejtoria e Arsimit që të punoj në implementimin e saj. Pastaj propozoi që të ketë edhe psikologë nëpër shkolla. Në fund i rekomandoi Drejtorisë së Arsimit që të fillon punën në përpilimin e një rregulloreje për nivelin zero.

Veli Karaça, anëtar i Kuvendit- lidhur me draft-rregulloren në fjalë paraqiti këto vërejtje: te neni 2, pjesa e fjalisë “...ofron shërbime efektive...”, tha se shkollat nuk ofrojnë shërbime, por ofrojnë mësim; te neni 5.8, tha se nxënësi mund t’i shikon punimet e veta, por nuk mund të bën vlerësimin e tyre; te neni 5.10, pjesa e fjalisë “të kërkojë mbrojtjen e vet...” , propozoi të zëvendësohet me këtë fjali “të jetë i mbojtur...”; neni 8.3 propozoi që të hiqet krejt, pasi që duhet të formohet një komision për vlerësimin e dëmeve; te neni 12.9, te fjalia “...t’i merret klasa...”, propozoi që së pari të thuhet “të merren masa”; te neni 13.2, në vend të fjalisë “të dorëzojë”, të thuhet “të përgatis”; te neni 13.12, në vend të fjalisë “...që ia ngarkon...”, të thuhet “...që ia cakton...”. Mandej duke iu referuar nenit 13.15, tha se përgjegjësia nuk delegohet, prandaj mësimdhënësi i përgjigjet vetëm drejtorit. Te neni 15.5, tha se nuk është zgjedhje e mirë që drejtori i shkollës me bërë zgjedhjen e mësimdhënësit të dalluar, prandaj propozoi që në përzgjedhjen e mësimdhënësit të dalluar të përfshihet edhe një komision nga këshilli i arsimtarëve.

Refik Ramaj, anëtar i Kuvendit- tha se ka pasur mundësi që draft-rregullorja ta ketë një aneks, përmes të cilit do të jepeshin sqarime që e njëjta ka qenë në diskutim publik nuk iu kanë përgjigjur qytetarët, por kësaj here për shkak të rëndësisë që ka kjo draft-rregullore do ta voton edhe grupi parlamentar i LDK-së.

Ferit Idrizi, kryesues i Kuvendit- përmendi të gjitha propozimet për ndryshime dhe plotësime në këto nene të draft-rregullores në fjalë: te neni 5.5 të fshihet kjo pjesë “pedagogjik-shkollor”, dhe të thuhet “mbi përfundimin e klasës...”; pastaj propozoi që nocioni “arsimtar” të zëvendësohet në tërë rregulloren me nocionin “mësimdhënës”; neni 5.13 të hiqet pjesa e fundit “ka të drejtë”, dhe në vend të saj të shtohet “...i është bërë e pa drejtë”; te neni 6.9 hiqet “1 €”, dhe thuhet “pa para”; pastaj propozoi të shtohet paragrafi 6.19 me këtë përmbajtje “Nxënësi është i obliguar të paguaj për dëftesë duplikat 2 €, kurse për diplomë të shkollës së mesme duplikat shumë prej 5 €”; neni 8.3 hiqet krejt; te kreu i IV-të, neni 10, titulli i kreut, propozoi të hiqet fjala “obligimet”, pasi që janë në nenin 11 obligimet e prindit; te neni 12.9 t’i shtohet fjalia dhe së pari të thuhet “...duhet të merren masa...”; te neni 13.8 të shtohet ky pasus “...ndërsa nota përfundohet me ngjyrë të kuqe”; te neni 15.5 propozoi që të thuhet “...drejtori i shkollës me një komision nga këshilli i arsimtarëve”; te neni 16.2 hiqet pjesa e fjalisë “të mos e përdorë celularin...”, dhe thuhet “kur e përdorë celularin...”; te neni 16.3 të fshihet fjalia “ndalohej mbajtja e kurseve private...”, dhe në vend të saj të thuhet “kur konstatohet se mban kurse private...”; nenit 17 t’i shtohet paragrafi 17.11 me këtë përmbajtje “detyrat e këshillit të shkollës dhe këshillit të nxënësve sipas UA-së”; te neni 20.6 në vend të fjalës “nuk duhet”, të thuhet “nuk lejohet”.

Në fund të diskutimit lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, Kuvendi pas votimit në mënyrë unanime vendosi me sa vijon:

Aprovohet rregullorja në fjalë, duke inkorporuar vërejtjet e anëtarëve të Kuvendit, të cilat i përmbledhi Kryesuesi i Kuvendit, F.Idrizi.

8. Shqyrtimi i propozim-vendimit për dhënien në shfrytëzim të përkohshëm të tokës në pronësi të Komunës, në fsh. Nedakoc.

Nasuf Aliu, drejtor i Drejtorisë për Ekonomi, Bujqësi dhe Zhvillim- njoftoi se IADK-ja ka realizuar disa punë të mira në sektorin e bujqësisë prej vitit 2007 deri në vitin 2009 në Komunën e Vushtrrisë, dhe poashtu njoftoi se në koordinim me Kryetarin e Komunës kanë nënshkruar një memorandum bashkëpunimi me IADK-në. Në vazhdim paraqiti sqarime shtesë lidhur me propozim-vendimin në fjalë.

Ismet Gashi, anëtar i Kuvendit- tha se është për t’u përshëndetur kërkesa për mundësinë e lehtësimit të bizneseve për zhvillimin e komunës sonë, por ka vërejtje që kërkesa është e datës 02.11.2010, e cila deri në këtë seancë nuk është paraqitur. Gjithashtu, këtu ceket se nuk do të kalon nëpër procedurën siç e parasheh ligji i cili ka hyrë në fuqi, prandaj kërkoi nga Zyra Ligjore që ta interpreton mirë, pasi që OJQ-së e cila përfaqësohet nga një qytetar i Vushtrrisë, në bazë të Ligjit për dhënien në shfrytëzim të patundshmërisë së Komunës nuk ka mundësi me ia dhënë pa procedurë. Mandej nëse thuhet pa procedurë të prokurimit, nuk dmth që edhe pa kompensim. Në fund tha se nëse përfaqësuesit ligjorë të Komunës e arsyetojnë që nuk po bëhet shkelje, Grupi parlamentar i LDK-së do ta përkrah, pasi që është në interesin e komunës tonë.

Sabit Kadriu, anëtar i Kuvendit- tha se mbi bazën e kontributit të IADK-së gjatë këtyre viteve në ndihmë fermerëve të profileve të ndryshme në Vushtrri, është mirë që Kuvendi ta aprovon kërkesën e parashtruar nga IADK, duke propozuar që t’ia gjejmë një vend më të volitshëm brenda territorit të qytetit, me qëllim që t’i krijojmë lehtësira fermerëve dhe me qëllim të zbatimit deri në fund të këtij projekti.

Melihate Basholli, anëtare e Kuvendit- tha se IADK-ja është një OJQ e cila shumë toka djerrina i ka shndërruar në toka të punueshme, shumë bujqëve iu ka krijuar mundësi të merren me blegtori, perimtari etj, por është shumë me rëndësi edhe edukimi profesional i tyre, dhe kryesisht i femrave. Pra IADK ka trajnuar mjaft nëna, që tani kanë mundësi t’i kryejnë punët në mënyrë profesionale, dhe disa prej tyre kanë filluar të merren me ekonomi të vogla familjare, prandaj propozoi që kjo

kërkesë të përkrahet dhe të gjenden forma që kërkesa në fjalë të realizohet sa më shpejt.

Bajram Mulaku, kryetar i Komunës- tha se përkrahja e kërkesës në fjalë ka arsyeshmëri të mjaftueshme, dhe fakti që po ipet në shfrytëzim për një periudhë 5 vjeçare, dhe pas 5 viteve e tërë ajo që ndërtohet i mbetet komunës, dhe në këtë mënyrë komuna mundet me dhënë me qira, por problemi është te ligjshmëria, mirëpo duke pasur parasysh se IADK-ja ka bashkëpunim me organizatat dhe qeveritë e jashtme, kemi menduar se mund ta mbështesim kërkesën në fjalë duke u bazuar në lehtësirat që i krijon për organizatat e jashtme Ligji për dhënien në shfrytëzim të patundshmërisë së Komunës, gjithashtu njoftoi se për çështjen në fjalë ka bërë konsultime edhe me ligjdhënësit.

Muharrem Shabani, anëtar i Kuvendit- tha se Grupi parlamentar i AAK-së e mbështet këtë propozim, por duhet të mbulohet ana formale-juridike, prandaj propozoi që të merret mendimi edhe i institucioneve tjera qendrore, pasi me ligj parashikohet edhe forma e marrjes së mendimeve, sepse përmendi një rast tjetër mbi rrugë te Nedakoci, që është premtuar fabrikë e djathit, punësime dhe investime, dhe gjithashtu është thënë që do t'iu merren të gjitha të drejtat dhe investimet që janë bërë, kurse afati ka kaluar, por akoma nuk ka ndodhur asgjë.

Në fund të diskutimit lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, Kuvendi pas votimit në mënyrë unanime vendosi me sa vijon:

Ipet në shfrytëzim të përkohshëm pa kompensim, në afat prej 5 vjetësh me mundësi vazhdimi, toka në pronësi të komunës, pjesë e parcelës kadastrale P-70202043-00110-0, Certifikata e pronësisë UL-70202043-00036, në sipërfaqe prej 1000m², ZK Nedakovc, për ndërtim të një "Qendre Edukuese Bujqësore" për zhvillimin e aktiviteteve të IADK-së (Iniciativa për Zhvillimin e bujqësisë së Kosovës).

Ndërtimin e objektit nga neni 1 i këtij Vendimi do ta financoi shoqata IADK, së bashku me donatorët tjerë ndërkombëtar.

Pas mbarimit të afatit të dhënies së pronës në shfrytëzim, ose ndërprerjes së parakohshme të marrëveshjes për shfrytëzim, e drejta e shfrytëzimit të tokës, si dhe objektit, i cili do të ndërtohet me të gjitha investimet do të mbesin në pronësi të Komunës së Vushtrrisë.

9. Shqyrtimi i dytë i propozim-vendimit për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullore për tarifa ngarkesa dhe jobja komunale.

Idriz Muzaqi, drejtor i Drejtorisë për Administratë- pasi që identifikoi dy gabime teknike në propozim-vendimin në fjalë, vazhdoi sqarimet shtesë.

Zeqir Hasani, anëtar i Kuvendit- tha se grupi parlamentar i AAK-së është kundër ngritjes së taksave në firmë, pasi që së pari duhet bërë një analizë në terren, poashtu është një krizë ekonomike, prandaj është më e arsyeshme të mblidhen taksat e painkasuara, se sa të rriten taksat në biznese të caktuara. Në fund lidhur me ndërmarrjet që janë jashtë komunës sonë, e që marrin tendera, nuk ka bazë juridike për t'i ngarkuar me taksë komunale.

Ismet Gashi, anëtar i Kuvendit- njoftoi se nuk merr pjesë në votimin apo mos votimin e kësaj pike të rendit të ditës, pasi që duke u bazuar në nenin 38.1 është konflikt interesi.

Pajazit Pllana, anëtar i Kuvendit- tha se vërejtjet që i ka dhënë në seancën e kaluar të Kuvendit nuk janë përfshirë në propozim-vendimin në fjalë, e që kanë qenë ndarja e ordinancave specialistike në operative dhe jo operative. Poashtu, ndarjen edhe për qendrën diagnostike dhe ordinancat stomatologjike, e që janë në numër të konsideruar, dhe kanë një tretman tjetër. Mandej nuk është bërë as ndarja e spitalit privat.

Sabit Kadriu, anëtar i Kuvendit- propozoi që kompanive të ndërtimit nga Komuna e Vushtrrisë t'iu jepet përparësi, pasi që shumë kompani nga Skenderaji që punojnë në Vushtrri, e nuk ka kompani të Vushtrrisë, kurse kompanitë tona e paguajnë tatimin.

Bajram Mulaku, kryetar i Komunës- tha se pjesa absolute e ndërtimeve që po bëhen në komunën tonë, janë nga Qeveria e Kosovës, dhe ata i shpallin tenderët. Pastaj tha se e mbështet propozimin që përparësi të kenë kompanitë tona, edhe pse në bazë të ligjit të gjithë janë të barabartë, por fatkeqësisht nuk kemi kompani që asfaltojnë rrugë në komunën tonë, pasi që ka qenë një e tillë, por ka dështuar, por shtrimin e kubëzave kryesisht po e bëjnë kompanitë nga komuna jonë. Në vazhdim tha se edhe vet nuk i mbështet ngritjet e taksave, por është thënë që jemi prej komunave që kemi taksat më të ulta, dhe po i ngrisim duke i harmonizuar me nivelin e taksave të regjionit.

Në fund të diskutimit lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, Kuvendi pas votimit me 19 vota “kundër”, 13 “për”, të tjerët “abstenim” në mënyrë unanime vendosi me sa vijon:

Propozim-vendimi në fjalë nuk aprovohet.

10. Eventuale:

a. Rishqyrtimi i vendimit që është marrë në seancën e datës 25.11.2010, lidhur me dhënien në shfrytëzim pa qira të lokaleve të dy shkollave për hapjen e kuzhinave.

Bajram Mulaku, Kryetar i Komunës- rishqyrtimin e vendimit në fjalë e arsyetoi se faktin që ligji nuk ia lejon drejtorive tjera, përveç Drejtorisë për Prokurim që ta procedon lëndën, prandaj për çështjen në fjalë tha se nuk mundet me proceduar Drejtoria e Arsimit, prandaj kërkoi që vendimit në fjalë të mos i ndryshohet përmbajtja, vetëm se duhet të procedohet përmes Drejtorisë së Prokurimit.

Në fund të diskutimit lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, Kuvendi pas votimit në mënyrë unanime vendosi me sa vijon:

Me këtë vendim lejohet shpallja e tenderit për dhënien në shfrytëzim të përkohshëm të lokaleve në dy shkolla të mesme të ulta në qytetin e Vushtrrisë, si vijon:

- 1. SHMU 1, përballë ish-Kooperativës Bujqësore në Vushtrri.***
- 2. SHMU 2, afër Stacionit Policor në Vushtrri.***

Lokalet në fjalë ipen në shfrytëzim të përkohshëm pa kompensim në kohëzgjatje prej 2 (dy) vitesh, me mundësi vazhdimi.

b. Kërkesë nga Elheme Isa për ndihmë financiare për sigurim të terapisë mjekësore, dhe kërkesa tjetër nga Ramadan Bajrami për ndihmë financiare për sigurim të terapisë mjekësore.

Pajazit Pllana, anëtar i Kuvendit- lidhur me kërkesat në fjalë, paraqiti sqarime profesionale rreth natyrës së sëmundjeve të tyre. Pastaj propozoi që kërkesës të parashtruar nga Elheme Isa, Kuvendi t'ia mbulon vetëm shpenzimet bazë, pasi që në këtë mënyrë iu mundësohet përfitimi i ndihmës nga subvencionet edhe rasteve të tjera. Kurse lidhur me kërkesën e Ramadan Bajramit, tha se i njëjti si punëtor i administratës komunale që është para pensionit, me mbi 40 vjet shërbim në këtë komunë, duhet ta ketë një tretman tjetër, poashtu gjendjen ekonomike-familjare e ka të rëndë, prandaj propozoi që t'i ndihmohet më shumë se kërkesës tjetër.

Bajram Mulaku, kryetar i Komunës- tha se kërkesat e tilla janë shumë të rëndësishme dhe është humane t'iu ndihmohet, por nëse vazhdohet kështu për një kohë shumë të shkurtë do të harxhohen subvencionet, dhe propozoi që kësaj here

t'iu ndihmohet kërkesave në fjalë me një shumë më të vogël, kurse herave tjera me pasë shumë kujdes.

Besim Jashari, anëtar i Kuvendit- tha se këto raste janë shumë të ndijshme, dhe secili prej nesh ka dëshirë që rasteve të tilla t'iu ndihmohet, por nëse vazhdohet kështu me marrje të vendimeve për t'iu ndihmuar, ku mund të ndalemi, cilat janë pasojat, pasi që mund të ketë pasoja shumë serioze nëse dikujt i ndihmohet, e dikujt tjetër nuk mund t'i ndihmohet.

Pajazit Pllana, anëtar i Kuvendit- propozoi që herave tjera Drejtoria për Shëndetësi përmes komisionit të formuar për trajtimin e kërkesave për ndihmë financiare për sigurim të terapisë, të bën rangimin e rasteve, duke dhënë pëlqimin se cilave raste t'i jepet prioritet për t'iu ndihmuar.

Ferit Idrizi, kryesues i Kuvendit- lidhur me dy kërkesat në fjalë, propozoi që Kuvendi t'iu ndan shumën nga 1.500 € për secilën kërkesë.

Në fund të diskutimit lidhur me kërkesat në fjalë, Kuvendi pas votimit në mënyrë unanime vendosi me sa vijon:

a. Aprovohet kërkesa e Elheme Isës nga Vushtrria, për ndihmë financiare në shumë prej 1.500.00 € (një mijë e pesëqind euro) për sigurim, blerje të terapisë mjekësore për shërim nga sëmundja e tumorit.

b. Aprovohet kërkesa e Ramadan Bajramit, nga fsh Pantinë, për ndihmë financiare në shumë prej 1.500.00 € (një mijë e pesëqind euro) për sigurim, blerje të terapisë mjekësore për shërim nga sëmundja e tumorit.

Mbledhja përfundoi në orën 16:20.

**Procesmbajtësi:
Albanez Tahiraj**

**Kryesuesi i Kuvendit
Ferit Idrizi**